

INTERVISTË ME SAKIBE DOLIN

Gjakovë | Data: 20 korrik, 2023

Kohëzgjatja: 111 minuta

Të pranishëm:

- Sakibe Doli (e Intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Sakibe, nëse mundeni me u prezantu, me na tregu diçka për kujtimet e para të fëmijërisë?

Sakibe Doli: Unë jam Sakibe Doli, jom e lindur në Gjakovë, lindur dhe rritur në Gjakovë në vitin, me 01.12.1953. Familje ime e origjinës është në familje shumë e madhe në Gjakovë, jemi shumë anëtarë familjesh. Normalisht duke u ndarë pastaj në familje më të ngushta. Ngase gjyshi jem ka qenë vet i pesti vëlla pastaj baba im vet i pesti e kështu domethonë këta secili ka pasë pastaj djem edhe sot kemi në numër t'madh të banorëve në qytetin e Gjakovës.

Më kujtohen rrëfimet e babait se si duke qenë shumë familje me djem gjithmonë kanë pasë ftesë nga Begi¹ edhe nga Curri,² domethonë Bajram Curri dhe Begut, të cilët kanë luftu edhe i kanë thirrë këta për me marrë pjesë, domethonë, në mbrojtje të tokave shqiptare. Pastaj me kalimin e viteve, unë isha shumë fëmi atëherë dhe s'e kom vu veshin shumë por me kalimin e viteve, Gjakova gjithmonë osht' shqu domethonë për ni kundërvënje që ia ka bërë armikut me vite.

T'rritesh me ni ambient të tillë edhe me ni familje ku gjithmonë ka dominu biseda për lirinë e atdheut atëherë domosdoshmërisht që ti s'ke kah ia mban edhe orientohesh në atë rrugë. Në moshën shumë t're, domethonë në shkollën fillore, m'kujtohen babai dhe shokët e tij edhe xhaxhallarët se si futeshin në ni dhomë, unë lexoja bukur si fëmi, edhe më merrnin aty në dhomë edhe lexoja vargjet e Fishtës. Na e dijmë që Fishta ka qenë i ndalun edhe në qoftëse zihej dikush me atë tekst, me atë libër në dorë domethonë patjetër që kishte me pasë pasoja t'mëdha.

Unë i lexoja ato vargje edhe tek mu si fëmi kanë ngjallë shumë emocion edhe dashuri për atdhe. Domethonë, Fishta ka qenë ajo drita e parë, shkëndija e parë. Pastaj, Radio Tirana edhe Televizioni

¹ Hysen Bej Kryeziu ose Cena Begi (1895-1927), nga Gjakovë, ishte prijës popullor, zv/prefekt i Krumës, Ministër i Brendshëm dhe diplomat shqiptar. Në Krumë ishte komandant i trupave kufitare dhe më 1915 arrestohet dhe burgoset prej austriakëve. Përleshet me trupat e Bajram Currit në Malësi të Gjakovë, të cilin e ndoqi deri në marsin e 1925.

² Bajram Curri (1862-1925), nga Gjakovë, politikan dhe një nga komandantët më të njohur guerilë të Kosovës dhe u bë i njohur në luftën kundër sundimit osman dhe serb.

Shqiptar ma vonë e kanë rritë pothuajse atë bagazhin tim për dashuri ndaj atdheut. Kosova dhe Gjakova gjithmonë kanë qenë të okupuara në kohën sa unë kam njohuri nga pushteti serb.

Në... ky pushtet çdo ditë që kalon shkonte duke i shtuar ato masakrat, duke i shtuar, duke i shtuar domethonë vrasjet, duke i shtuar burgosjet dhe ni zym t'madh, ni inat t'madh kishte në qytetin e Gjakovës. Këta e kom kuptu shumë ma vonë pas luftës kur në një banesë që isha futur për t'jetuar ngase shtëpia më ishte djegur, e kam pa ni testament të ni komandanti të lartë të Serbisë, i cili kishte folur shumë për qytetin tonë. Sepse ai kishte shërbyer në zonën kufitare.

Këta e kuptova domethonë ma vonë se çfarë inati kishin. Pse na ishim etnikisht të pastër, me dy përqind të serbëve që jetonin këtu, ata domethonë e flisin gjuhën shqipe. Asniherë nuk kemi pranuar që të bashkëjetojmë apo të martohemi me ta, të përzijmë gjakrat me ta. Pastaj, mundësitë për shkollim na ishin dhanë neve pak ma herët edhe kështu që edhe si zonë kufitare i pengonte shumë serbët. Ata i kishin ruajtë krejt atë inat dhe e shfryn në periudhën e luftës por vazhdimisht edhe gjatë, gjatë historisë tonë si qytet.

Duke kaluar vitet në Radio Tirana ne e dëgjoni shpesh... sikur shumica e Kosovës ne e donim Enver Hoxhën sepse identifikohet me Shqipërinë. Shqipëria për ne ishte atdheu jonë. Normalisht që kishim ni mall për shkak të atij klonit që na ndante, domethonë, deri vitet e '90-ta nuk kemi guxuar të shkojmë lirisht atje. Malli i madh për... sikur ku e ka njeri ni dashuri për nanën qashtu e kemi pasë na për Shqipërinë. Televizioni pastaj na fuqizoj edhe ma tepër ndjenjën kombëtare.

Ma vonë e kuptum kush ishte Enver Hoxha po për qat' kohë na ka shërby shumë. Sepse duke identifikuar Shqipërinë me të, na e donim edhe ma shumë Shqipërinë. Unë, për shembull, kur e kom dëgju në kongresin, nuk më kujtohet në cilin kongres, po ka pasë thanë, "Pa u bashku Kosova me Shqipërinë edhe dy Gjermanitë edhe dy Koretë, bota s'ka me pasë qetësi". Unë e shihsha në botën time si një vizionar shumë të madh. Domethonë m'u bashku këto vende, domethonë ky veç me pasë vizion të madh edhe me qenë shumë i sigurt m'i paraqit ato në kongres.

Kështu që ishin momente që neve na rritshin edhe ma shumë, na frymëzonin për atdhedashuri. Pastaj, pas shkollës fillore, fillova me lexu nga pak libra ilegale. Ato vishin dorë më dorë. Më shumë më jipte axha im, unë pastaj ju jipsha shoqeve t'mia në klasë. Ishim grupe grupe. Sepse gjithmonë ka qenë një shtresë që i ka shërby pushtetit edhe shtresa e gjera që e kanë luftu pushtetin. Në çdo qytet besoj të Kosovës. Ne ruheshim nga ajo shtresa që ishin në pozita vendimmarrëse në kohën e pushtetit.

Ndërsa i kishim rrethin tonë. Ni rreth i cili dallonte shumë edhe për nga gjendja ekonomike edhe për nga prioritetet që kishin ata. Qoftë në shkollim, qoftë, kudo kishin prioritet. Në qoftëse organizohet diçka, ata ishin ma me prioritet. Edhe pse kah ana jonë kish shumë nxansa të fortë, nxansa të mirë por megjithatë gjithmonë ka pasë dallime, ishalla do të zbehen tash e tutje. Bisedonim edhe fillum të shkrujmë vjersha për atdhe dashurinë, për Shqipërinë, për Kosovën, për bashkimin kombëtar.

Kur e thashë Odhise Paskali erdhi në qytetin tonë, domethonë para viteve të '90-ta, kjo ishte ni ngjarje shumë e madhe për ne. Na, ai grupi, dolëm ta takojmë edhe meniherë ram në sy të policisë. Atëherë ishte UDB-a, edhe pse shërbyes ishin edhe shqiptarë të kësaj UDB-e. Nga frika, nga frika se ish viti i parë gjimnaz, atëherë i largum ato fletoret e poezive edhe ktu me këtë rast ni pjesë e frymëzimit për mua është këputë në atë moment.

Ne mendonim tash edhe për familjet tona jo vetëm për vete. Po gjithmonë me kujdes të shtuar që mos të vunë edhe pasojat familja ose rrethi jonë familjar dhe shoqëror. Nga ajo kohë, domethonë, fillun në gjimnaz m'u organizu, nga fundi i gjimnazit, m'u organizu si treshe, grupe ilegale. Ishte shumë herët por... burri i tezës ishte i burgosur politik dhe gjithmonë unë shoqërohesha me fëmijtë edhe aty fillun aktivitetet e para ilegale duke shkruar pamflete me raste të vizitave të udhëheqësve që vishin nga Jugosllavia në Kosovë. I kundërshtojshim domethonë këto vizita edhe kërkonim gjithmonë liri edhe pavarësi për Kosovën tonë.

Me 1974 kur u vendos autonomia e Kosovës, ne e konsiderum si arritje. Sepse kjo ka qenë edhe punë e udhëheqësisë së asaj kohe por edhe njerëzve që punonin gjithmonë në ilegalitet. Për shembull, kunati im ka ra në burg për ngritjen e flamurit. Vajza e kunatit për 28 nëntor i ka ngrit s'di sa flamura vetëm, me dy-tre shokë të klasës i ka ngritë flamurat në Gjakovë që ka qenë absurdi ma i madh i asaj kohe. Bazuar në pasojat që linte pushteti i egër serbo-sllav, serbo-jugosllav.

Me rastin e pamfletëve ni shok ka ra domethonë në burg edhe normalisht që te ne u shtu frika shumë e madhe edhe për shkak të babës tim edhe për shkak të axhallarëve t'mi, kishim frikë se mund t'i merrnin ata në burg. Megjithëse këta nuk kanë kursy as fëmi as të ri. E kanë marrë djalën e tezës i cili vinte edhe te na edhe na shkojshim aty edhe bashkëpunojshim. E kanë pytë edhe për mu. Tashti unë gjithmonë kisha frikën se çfarë do t'më ndodhë, do t'ma ndalonin shkollën, nuk kom me përparu n'jetë edhe mijëra mendime më vinin në kokë. A t'vazhdoj ma tutje apo të tërhiqem.

Të tërhiqem ishte tradhëti ndaj shoqeve, edhe pse ishim t'ri, por ishte tradhëti. Të vazhdoj e kisha frikën e vllazërve, t'babait e kështu me radhë. Në familjen tonë kemi qenë gjashtë fëmijë edhe prindërit e mi, tetë anëtarë. Baba im ka qenë punëtor. Na ka rritë domethonë me djersë t'ballit edhe na ka shkollu t'gjithëve. Është munduar që neve të mos na mungoj asgjë sepse ka punuar edhe në punë publike edhe private në mënyrë që e vetmja mënyrë ka qenë që t'na shkolloj sepse përndryshe s'do t'ia kishte dalë.

Shpesh herë unë kom pa n'shpi disa letra edhe e kom pytë, "Çka janë këto?" "Janë letra të vet kontributeve", m'thoshte, që kanë pagu për ndërtimin e rrugëve, për ndërtimin e urave, për ndërtimin e Shkupit. Domethonë krejt Kosova e ka ndihmu me vet kontribut të punëtorëve. Sepse shteti jugosllav nuk ka investu në Kosovë, ai veç ka marrë nga Kosova edhe s'ka investu kurgjo. M'kujtohet

me ni shkrim e pata lexu nga shumë lloje të rrugave që janë në Jugosllavi, Kosova e zen vendin e fundit, domethonë ka pasë dallim.

Edhe pse këta proklamoheshin para botës se krahinat janë të njëjta, të barabarta me republika, kjo ishte ni absurd. Sepse ne dallonim shumë, jo vetëm në aspektin ekonomik, në aspektin zhvillimor. Na dihet, unë fëmi e mbaj mend, Trepça punon Beogradi ndërton. Kjo nuk ka dalë kot. Kjo ka dalë nga ni realitet. Sepse ata kanë shfrytëzu Trepçën edhe e kanë shfrytëzu për nevoja jashtë Kosovës. Sa herë që kom dalë jashtë edhe jom kthy në Kosovë, unë kom qajtë. Sepse e kom pa dallimin e madh në mes të Kosovës edhe republikave tjera. Osh t' ni dallim tepër i madh. E këta proklamojshin gjithmonë për barazi, vllaznim-bashkim.

Vetëm pse domethonë për ta mashtru opinionin ndërkombëtarë se Jugosllavia osht' ni shtet që i respekton të drejtat e njeriut. Askund ma shumë se në Kosovë nuk janë shkelë të drejtat e njeriut. Baba im më ka treguar se ka pasë formu ni grup ilegal me disa shokë të Gjilanit për me rrxu Rankoviçin. Domethonë, ka qenë ni grup, shokë që i ka pasë në ushtri. Mirëpo ka ra ni shok atje në Gjilan në burg edhe grupi u shpartallu. Se edhe mënyra e komunikimit ka qenë shumë ma e vështirë sesa sot, Gjilan-Gjakovë.

Këta kanë qenë dy-tre veta nga Gjakova ata kanë qenë katër veta nga Gjilani. E kanë formu grupin po me ramjen e parë, grupi osht' shpartallu edhe kanë mbetë kështu pa organizim të matutjeshëm. Unë gjithmonë i thojsha, “Ku t'ngjava ty?” (qeshë), “Jo”, thojke, “ke dalë vet. Se unë i kom edhe gjashtë tjerë po nuk janë, nuk marrin iniciativa sikur i merr ti. Don vet për këtë arsye edhe angazhohesh”. Kështu domethonë neve na kalojshin ditët në robëri me lajme shumë të errëta.

Vishin djem nga ushtria në kufoma.³ Tregojshin se si janë marrë njerëzit në shpi natën edhe ju është gjujtë nga treni, jo, me arsyetime të kota. Vraj UDB-a edhe arsyeto në nifar' mënyre. Mirëpo populli këto gjëra i dinte edhe gjithmonë shtohet ajo nevoja për liri edhe pavarësi. Tashmë grupet tona ishin bo ma shumë edhe ni anëtarë i grupit komunikojke me ni anëtarë tjetër të grupit me rastin e organizimeve të ndryshme, me rastin e pamfletëve, me shpërndarjen e librave, me materialin propagandues që vinte nga bota perëndimore, sidomos nga Zvicra.

M'doket “Lajmëtari i Lirisë” ka qenë ajo fletushka edhe njo tjetër që tash për momentin s'po m'kujtohet. Ato shkonim në Prishtinë i merrnim, e binim... domethonë ishin disa numra që ka qenë shumë rrezik mirëpo e kemi sjellë pa problem. Me autobus, e binim me autobus edhe shpërndanim te grupet tona. Ka pasë njerëz nga qyteti edhe nga fshati.

³ I referohet rasteve kur ushtarë të vrarë ose të vdekur në rrethana të dyshimta gjatë shërbimit ushtarak silleshin në arkivole. Shpesh, autoritetet jepnin shpjegime zyrtare që nuk përputheshin me dëshmitë e familjarëve apo me të dhënat e ngjarjes.

Ne kryesuesin e grupit e kemi pasë nga fshati. Ai vllau i tij është vlarë në ushtri, pa asni shpjegim ka ardhë kufoma, e kanë sjellë ktu. Edhe kur kemi shku na për t'vizitu ai djali është largu nga shtëpia. Sepse meniherë UDBA ka shku për ta kontrollu shpinë edhe ka pasë dyshime se, ky punonte në ni fabrikë, edhe aty çdo mëngjes është mbush me pamflete, sidomos pas vrasjes së vllaut. Duke akuzu pushtetin e kështu me radhë, për mbajtjen e pamfletëve. Ata kanë dyshu që ky osht' ai që, një ndër ta domethonë, që i ka shpërnda. Ai është detyru me ikë edhe mos me qëndru te varrosja e vllaut. Ne si grup kemi shku edhe pse pa komunikim me njëri-tjetrin. Vetëm nana e tina na ka njoftë sepse kemi majtë disa mbledhje atje.

Po shumicën e mbledhjeve i kemi mbajtë në shtëpinë time. Unë e kom pasë dhomën time t'veçantë edhe aty vishin. Domethonë me lejën e babait me përkrahjen e tij. Nana gjithmonë ka pasë frikë edhe m'thoshte, "Je femër, ruju, ruju. Çka na vyn jeta neve me t'ndodhë ty diçka? A e din kush janë shkijet? A e din çka t'bojnë ata? E n'burg çka mujnë me t'bo?" Gjithmonë ajo ka pasë frikë ndërsa babai gjithmonë ma ka hapë derën. Kjo mu m'ka bo ma t'fortë me vazhdu edhe mos m'u ndalë. Pas pavarësisë filloj nifar' fryme, jo universiteti, jo... ni frymë shumë e lehtë domethonë...

Anita Susuri: Pas '74-tes po mendon a?

Sakibe Doli: Po. Sepse ata nuk ndryshojnë shumë. M'kujtohet ni, si ngjarje domethonë, shumë e lavdishme, e arritshme osht' universiteti. Dihet që për këtë universitet edhe për këtë ka pasë sakrifica. Organizimi i demonstratave të '68-tes ku kanë marrë pjesë edhe djemtë e axhës, organizimi i demonstratave tjera domethonë. Gjithmonë Kosova ka vlu me këto ngjarje për t'arritur në ditët që sot ne jetojmë. Ka pasë të burgosur nga këto demonstrata. Por, ni rezultat u arrit domethonë.

Hapja e universitetit ndikoi në shkollimin e brezave, në shkollimin e vajzave. Unë gjenerata jeme asni vajzë nuk ka mbetë pa fakultet. Ama kemi msu shumë. Tash ta krahasoj atëherë me tash, shkolla m'duket ma e lehtë tani (qeshë). Kemi msu shumë, kemi qenë domethonë të edukun n'frymën patriotike. Unë kam marrë gjuhë-letërsi sepse ajo m'ka flejt ma së shumti. Rilindja Kombëtare osht' pjesa që mu m'ka pëlqy ma së shumti. Aty dihet shkrimtarët janë patriotat ma t'mdhej që kanë dhanë kontribut për kulturën dhe letërsinë tonë por edhe për çlirimin kombëtar.

Shumë me andje kur e kom marrë ditarin n'dorë e kom shpjegu ma me ëndje e kom shpjegu Rilindjen Kombëtare, p'i krejt letërsisë. Duke qenë domethonë gjithnji në kontakt me rilindasit edhe me njerëzit që luftonin me shumë vështirësi çdo ditë, ti veç vjen e rritesh edhe forcohesh edhe ma shumë edhe nuk ki frikë ma për asgjë. Interesant osht' se frika osht' njerëzore, ka pasë raste që jo frikë po frikë t'madhe kom pasë, por për m'u ndalë në aktivitet ma nuk ka pasë dilema te unë. A të ndërpres a të vazhdoj. Kjo ka qenë domethonë ajo leja e përhershme që ia kom dhanë vetit edhe me përkrahjen e familjes që kom pasë në jetë.

Pas kësaj domethonë ne fillim pak a shumë, erdh diplomimi, erdh punësimi. Por, nuk ma dhanë pëlqimin ideo politik edhe më lanë të shkoj të punoj në ni fshat në zonë kufitare me Shqipërinë. Fshat i largët, fshat që sapo kish fillu shkollën fillore. Ndërsa unë isha... prej klasës t'katërt e kish shtu edhe katër vite, domethonë, kish bo shkollë fillore. Zonë kufitare. Duke qenë zonë kufitare gjysa ishin me pushtetin, gjysa ishin patriotë. Aty e bëra rrethin tim domethonë. Sepse njerëzit që i kishin njerëzit në Shqipëri, domethonë, ata vishin ilegalisht.

Ka pasë rast që osht' shumë m'vjen m'dhem shpirti kur e them por ka pasë njerëz të tillë që ishin në partinë komuniste që e kanë lanë mysafirin e vet, dajën e vet aty edhe kanë shku kanë lajmëru nga frika. Kjo osht' ni tradhëti që unë kur e kom dëgju pastaj atij njeri nuk mujsha ta shikoj n'sy. Domethonë t'punojsh me ni rreth të tillë kur gjysma ishin atdhetar e gjysma ishin ma pak se gjysma por ishin që bashkëpunojshin me pushtetin, nuk ka qenë e lehtë.

Më ka ndodhë që në shkollë kanë ardhë tri herë m'kanë marrë prej orës të mësimit në biseda informative. Organizimin e demonstratave, për nxanësit, për shembull, kanë shkru ndonjë parollë "Kosova Republikë" në muret e shkollës. Gjithmonë isha unë ajo që u dufsha me u marrë në përgjegjësi. Herën e parë kur m'kanë marrë, e kom pa në sytë e nxansave, klasa e shtatë edhe pse t'vegjël, i kom pa t'mbushur me lot edhe kanë marrë me ardhë me m'përqafë. Ai operativ i policisë i ka ndalu.

Nuk e disha çka ka me ndodhë me mu. A kthehna ma a jo. Nifar', ni ndjenjë e pa përshkrushme ka ndodhë për herë t'parë. Ni thyrje shpirtërore tek mua sepse kisha dëgju për burgjet, kisha dëgju... thojsha maroj, me këta maroj gjithçka. Mirëpo edhe kjo osht' punë me fat edhe gjetuni. Atëherë ishin operativat hala shqiptarë domethonë. Ata n'vend se domethonë, me çu qashtjen me tutje m'thirrshin me bashkëpunu. Domethonë me lajmëru kush po vjen prej Shqipërisë, kush p'e sjellët n'shkollë kështu, çka po bohet n'shkollë. Unë ata kurrë s'e kisha ba.

Thojshin, "Rri qitu se mirë je, nuk munësh me ardhë me jep msim n'qytet". U msova. Punova që edhe te nxanësit e mi domethonë me ngjallë qit' ndjenjë. Gjuha shqipe e ka edhe qat' detyrë. Për shembull, merrsha shembuj në gramatikë në gjuhë, merrsha shembuj domethonë të gjithë që u lidhshin me Rilindjen Kombëtare, me Shqipërinë, me dashurinë ndaj atdheut. Shumica e nxanësve e kishin përqafu shumë atë ndjenjë edhe unë kur i lexojshim hartimet e tyne, nuk muj m'i përshkru ato ndjenja sa e lumtur isha, që nashta edhe fëmijtë e atyne familjeve që unë dyshojsha që ishin përkrahës të pushtetit kishin reflektuar edhe ishin frymëzuar edhe reflektonin krejt ndryshe nga prindërit e tyne.

Kjo ishte ni rezultat i punës time. Aty në fshat, thashë, profesori i historisë, profesorët e gjuhës, arsimtarët, ishin si grup. Sepse na lidhte i njejtë asi... tash në fshat unë fillova m'i formu grupin tjetër ilegal. Po ashtu ni msuse e gjuhës u fut, ni arsimtar i fiskulturës edhe ni profesor i historisë. U formu edhe ni grup aty n'fshat sepse kishte nevojë që t'hapej rrethi. Jo vetëm qytet edhe një bashkëpunon

me Rekën e Keqe po tash na vinte edhe kjo zona e Hasit, sepse ishte zonë kufitare. Shumë ishte interes për ne që me pasë edhe aty bashkëpunëtor.

Fillum. Aty ish ni i burgosur politik që edhe ai siguronte material propagandues nga perëndimi edhe fillum edhe aty m'i shpërnda. Ti e shishe që çdo ditë situata po ndryshon. Aty ku dominonte partia komuniste edhe ni pushtet tjetër, filloj njerëzit, nxënësit fillun ta ngjallnin edhe ta ndryshonin domethonë sjelljet e tyre në raport me vendin, me Kosovën edhe me Gjakovën. Pas tri informatave informative, domethonë, që nuk mujtën me m'thy atëherë filloj domethonë, me ra partia komuniste.

Në vitin '81, kur demonstratat shpërthyn në krejt Kosovën, unë kisha dy vllazër student edhe ata ishin shumë keq ngase policia i kishte rrahur fort. Nuk mujsha me lanë msimin edhe me shku se edhe bishe n'sy. Ti u dufshe me kujdesin ma t'madh. Por gjatë javës kishim ni ditë t'libër edhe shfrytëzova edhe shkova në Prishtinë. I takova. Njëni vlla ishte shumë keq por pas disa kohësh domethonë kanë punu edhe mjekt ilegal edhe kështu e mori vetën.

Mu m'dhimke zemra pse në Gjakovë s'po fillojnë ende demonstratat. Teuta Hadri ka pasë grupin e vet, e ka pasë ni shoqe e grupit tonë u kanë e lidhne me grupin e Teutës. I tregon shoqes tonë që nesër me datën kaq domethonë në ora kaq fillojnë demonstratat në Gjakovë. Kjo ishte domethonë ni gzim i madh sepse u nijsha keq. U nijsha keq ndaj shoqeve që i kisha edhe t'fakultetit. U nijsha keq edhe ndaj grupeve. Por, erdh momentie dhe pesë veta vetëm dolëm.

Thirra plot shoqe nuk u bashkangjitën sepse kishin frikë. Burra ka pasë mjaft. Aty ishim, na futën si n'mes për mos me ra shumë n'sy se pesë veta bijshin gjithsesi n'sy por na futën n'mes edhe ishin lagja jonë, ishin pothuajse krejt lagja në protestë. Ishin njerëz që i ngjishim se ishin të Gjakovës por ka pasë edhe disa fshatrave përreth. Aty domethonë u fillu demonstrata duke, ni djalë i gujti reklamat e filmit ajo boni bum se u mblodhën edhe ma shumë njerëz edhe pastaj u hap flamuri.

Kemi qëndruar aty derisa filloj policia, duke bërtitë, "Kosova Republikë", "Dojmë pavarësi", "Bashkimin kombëtarë", shumë kërkesa. Se çdo demonstratë kërkesat shtoheshin. Edhe ktu tashti na thanë që ju jeni pesë veta, keni me ra n'sy shumë edhe gjith ajo polici... nga pallati i kulturës ishin hypë naltë në katin e sipërm të pallatit, fotoqafshin. Thojsha, s'ka shpëtim ktu. M'u dhimke shkolla. Por, megjithatë jeta s'kish ma vlerë, nuk kish frikë ma edhe në qoftëse e hupi punën, thojsha, ia vlen për këto gjëra.

Na murr' ni njeri, ni shofer tha, "Futuni n'makinë teme", e njëfshim ata. Na largoj para se me ndërhy policia me gaz lotsjellës edhe m'i njeke. Protesta u bo e madhe sepse u bashkangjitën edhe studentat të cilët jetonin në konvikt. Studentat e shkollës së lartë pedagogjike. Unë mendoj që e arriti qëllimin e saj dhe unë u qetësua se Gjakova nuk mbeti mrapa Prishtinës edhe qyteteve tjera të cilat kishin organizu protesta të tilla, demonstrata të tilla. Pas demonstratave...

Anita Susuri: Po du edhe diçka me ju pytë, i përmendët vllaznit e juj edhe që mjekët kanë punu ilegal. M'tregoni pse ka qenë e vështirë me shku n'spital ata me kërku ndihmë?

Sakibe Doli: Ndoshta edhe kanë pasë frikë. Sepse dihet që policia gjithkund ka dominu. Ata duke u bazuar në gjithë atë dhunë që ka përdorë policia për vllaun tim kanë thanë që e ka hupë vetëdijen s'disa orë s'ka ardhë n'veti, krejt i gjakosur. I dyti ka qenë. Tashti me shku n'spital n'qat' gjendje, edhe ai ka pasë frikë po kumeditë e kishin burgosë. E vetmja mënyrë me shpëtu nga burgu ka qenë m'u fsheh dikund edhe m'i thirrë mjek ilegal. Besa student i mjekësisë ka qenë që i ka ndihmu edhe te plagët e te kthimi i vetëdijës, e besa edhe ushqim ka marrë, insulina. U çu n'kamë.

I njeiti vlla, domethonë këto kanë ndodhë me 11 mars, i njeiti vlla ka ardhë me 2 prill në Gjakovë me marrë pjesë në demonstrata. Tashti, kur e sheh, baba jem ish dalë si, ish dalë si shikues, s'e di, nuk e kom ni term. Ai ish dalë edhe për me na nejt neve afër po edhe n'qoftëse osht' nevoja, e kom pa n'xhep e ka majt ni, ni ksi, dana, ni parë dana edhe ni shtrafciger i kish pasë. Bile thojke ni polic muj diçka m'i bo. Këto ishin armët tona, nuk kishim tjetër mundësi.

Pastajata u shërun, e morën vetën shpejta. Pas kësaj, domethonë, më duket se ka ra komiteti. Që fillun m'i dorëzu ato librezat e partisë. Si ka ra komiteti janë ardhë atje m'kanë thirrë me punu n'gjimnaz. Drejtori i gjimnazit ka ardhë vet, m'ka thirrë. Pastaj, masiqë m'ka thirrë e ka shpallë konkursin për me m'pranu. Ai veç m'kish pranu. Tani normal që i kisha pak ma t'lehtë sepse atje n'fshat kom dhanë kontribut shumë, kom ndryshu mentalitetin e fshatit.

Kom ndryshu edhe kulturë, pak ndiku në kulturë. Sepse vajzat nuk i çojshin n'shkollë. Unë kom shku familje n'familje, kom folë me prindërit e tyre edhe vitin e dytë t'punës time pesë vajza i kanë çu n'shkollë, sot janë msuse. Kjo domethonë, nashta nuk osht' punë e madhe, po për mu ka qenë ni satisfaksion i madh sepse çka domethonë tash vajzat m'u shkollu edhe me shku me shërby domethonë n'vend t'msuseve që vinin nga qyteti.

Sot unë komunikoj me ato edhe jom shumë krenare që ato, edhe pse domethonë, nuk e kanë keqpërdorë qat' tolerancën, qat' lejën që prindërit e tyre ju dhanë edhe pse ata kanë pasë t'drejtë m'i shkollu çikat po mentaliteti ish i tillë. Atje domethonë sa vite ka punu shkolla, asni vajzë e fshatit s'ka shku n'shkollë. Pastaj, ju ndihmojsha për plotësimin e nevojave të ndryshme.

Në qoftëse ishin vizitu te mjeku kishin barna... mjeku vinte në ambulancën e fshatit, ata kishin nevojë barnat m'i ble në qytet se s'kishte faramci. M'dilshin rend gratë kah s'disa rresht i thojsha, "Po ju përzi". Janë disa gjëra t'vogla që ato kurrë s'un i harroj. Unë edhe sot kur i takoj me shumë respekt ata përulen para meje por edhe unë para tyre. I dua edhe m'dojnë edhe nuk më harrojnë asniherë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Zonja Sakibe, po du pak me ju pytë për jetën kulturore që ka qenë në Gjakovë. Sa e keni përcjellë ju? Si ka qenë ktu?

Sakibe Doli: Gjakova ka pasë teatrin profesionist. Domethonë tri qytete kanë pasë profesionist teatër edhe janë vu n'skenë drama shumë t'mira. Ma shumë për shkak të pushtetit vëheshin komedi po megjithatë edhe drama nuk ka çalu. E kom përcjellë rregullisht, sipas mundësive. Ish degë e jemja domethonë edhe nuk më ka shpëtuar edhe ni pjesë që nuk e kam shiqu ose s'kam marrë pjesë.

Teatri ka qenë ni frymëzues për gjeneratat e reja. Sepse aty pastaj osht' shpërnda fryma, fryma edhe me përmbajtje sidomos te pjesët me përmbajtje atdhetare. Osht' ni frymë që është shpërnda në qytet. Në këtë kohë fillun të vijnë edhe grupet nga Shqipëria. M'kujtohet niherë erdhi ansambli shtetëror. Na, si zakonisht, krejt grupet që ishin ishin t'parët aty. Ish vështirë me ardhë te bileta sepse dihet biletat i merrnin pushtetarët.

Ne hijshim sikur protestë. Ja kishim me hi ja nuk kish me ndodhë mos me u fut edhe na. Tani ish grumbull i madh i njerëzve, u shtyjin për me ardhë... policia reagojke. Niherë ishim hypë në ballkon edhe duke gjujt ata na shtyn, na gjujtën poshtë. Por, megjithatë depërtum edhe hyjmë. M'kujtohet këto grupet i përcjellsha jo vetëm në Gjakovë por edhe në Prishtinë sepse zakonisht mbaheshin natën këto organizime, masiqë e kisha kry shkollën.

Edhe m'kujtohet isha shku edhe në Prishtinë, Radio Shkodra, ishin kangëtarët, ishin kombinu po kish ardhë në emër të Radio Shkodrës ni grup edhe na shkum te garderoba. Unë shkrujsha me njerëzit nga Shqipëria, me këngëtarë... niherë e pata marrë Radio Tiranën në telefon, ish telefonata e parë që u bo prej Gjakovës, direkt që u lidha. Jom konë befasu qysh mujta m'u lidhë me ni emision edhe pata komuniku me udhëheqësin. Pastaj, ni kohë t'gjatë shkrujta letra me to.

Kur shkova unë për herë t'parë në Shqipëri i thashë, "Gjithë atë propagandë na keni bo". U befasova, u befasova nga mjerimi që pashë atje. Thashë, "Qysh na keni", s'mujsha m'i thanë na keni gënjy po thashë, "Ky osht' mashtrim, po na nuk e dishim as vet", thashë, "ju keni pa televizionin italian po shteti na thojke është propagandë, krejt janë propaganda edhe na e kemi ngulë n'kry që është propagandë". Domethonë qato grupet e Shqipërisë u bojke festë e madhe, festë e madhe në Gjakovë.

Në stadionin e qytetit, në stadionin që sot e kanë shkatërru duke ndërtuar banesa, aty na kanë shkatërru ni pjesë të kulturës edhe na kanë hupë ni pjesë të rinisë sonë. Sepse ajo ka qenë, ajo ka qenë dashtë me mbetë e tillë si simbol i kulturës. Aty kur ka ardhë ansambli shtetëror, Fitnete Rexha m'kujtohet, njerëzit janë entuziasmu, kanë shprehë emocione, kanë shprehë atë mllefin e madh ndaj pushtuesit në atë koncert.

Ka krejt qyteti ka qenë n'kamë, nuk ka pasë, stadioni plot nuk ka pasë vene edhe jashtë stadionit duke i përcjellë se për herë t'parë ishin ardhë vllazërit edhe motrat nga Shqipëria që jepnin ni koncert në Gjakovë. Pastaj grupet e teatrove që vishin. Krejt, ka qenë e pamundur unë mos m'u fut m'i pa, m'i përcjellë. Tash kur shkojshim n'qytet tjetër ai ishin, agjentat ishin të Kosovës që i përcjellshin këta n'krejt Kosovën.

M'tha, "Edhe ktu je ardhë a?" Në Prishtinë ma tërhjeki vrejten. e në Gjakovë isha fut në garderobë edhe folsha me artista, me kangëtarë. M'tha, "Edhe ktu ke mrri a?" Thashë, "Ktu osht' qyteti jem, ktu unë muj me t'qit' ty prej ktuhit" (qeshë). Domethonë kjo është ni arritje, grupet që kanë ardhë nga Shqipëria, teatri në anën tjetër, filmat shqiptarë, pak qata sa ishin kishin ndikuar edhe ma tepër në ngritjen e nivelit të ndjenjës patriotike te qytetarët.

Janë disa ngjarje që nuk harrohen që t'lojnë mbresa për krejt jetën. Tash luajnë filma shqiptarë për natë po kush ka kohë m'u marrë me ta. E ki kuptu tashma peshën e tyre. Por, për kohën kanë qenë domethonë pa ekselancë...

Anita Susuri: E ktu në dhomën e përgatitjes që thatë, çka keni bisedu për shembull me ta? Çka ju kanë tregu ata juve?

Sakibe Doli: Për shembull, takimin e parë që s'dishim çka me folë, "Rrnoftë Enver Hoxha" (qeshë). Ni djalë i lagjës tonë i tha, a din, hupshin fjalët në takimin e parë. Pastaj hapeshe biseda. Ata kanë qenë shumë ma t'rezervuar, sistem i egër. Kuptohet kangëtari, ni kangëtare si ka hy në Shqipëri ka thanë, "Erdhëm në skëterrën tonë". Se e ka pa domethonë në Mal të Zi, edhe Kosova ju ka dokë ma e mirë se Shqipëria. Kanë pa në Turqi, kanë pa... kur e ka thanë këtë fjalë, ata agjentat me veti edhe meniherë e kanë burgosë edhe e kanë dhunu n'burg e ia kanë hupë jetën.

Ata ishin ma t'rezervuar ndërsa ne flisshim. Domethonë na e dojmë Shqipërinë, na kemi qef m'u bashku me ju. Ata shumë ma t'rezervun. Nuk u shprehshin shumë. Vetëm m'kujtohet ni drejtor i Radio Shkodrës tha, "Qysh", tha, "na kanë marrë n'qaf", tha, "na kanë nda". Se e shihke entuziazmin e pritjen që u bojke, qytetarët që ju bojshin. Thojke, "Qysh ka ndodhë kjo m'u nda vllazërit e motrat në mes veti?" Dihet ma, pushteti. Ai Enver Hoxha sa u paraqit patriot, sa, në të kundërtën ka vepru ndryshe. Ma vonë ma e kuptum.

Kështu domethonë jeta kulturore edhe pse n'qat' pushtet nuk ka qenë e varfër, ka qenë e organizune. E ka lujt rolin e vet kultura edhe universiteti e kanë lujt rolin e vet në zhvillimin edhe përparimin e shqiptarëve. Në hapjen e mendjes edhe syve për m'i kuptu që diçka ktu nuk osht' n'rregull. Shkelje e të drejtave të njeriut, domethonë, është bërë ma së shumti në Kosovë. Burgjet e Serbisë kanë qenë ding {onomotope} me t'burgosur shqiptarë. Po edhe Gjakova ka pasë shumë t'burgosur.

Qyteti i ka vlerësu t'burgosurit politik. I ka vlerësu edhe janë frymëzu nga vepra e tyre. Unë, për shembull, jam frymëzu nga vepra e t'burgosurve politik. I kemi çmu si njerëz, domethonë, të idealit, si njerëz që ndryshojnë nga shtresat tjera të qytetarëve. Dihet, pushtetarët çfarë përkrahje kanë pasë, çfarë, nashta edhe i kemi urrejtë por këta i kemi pasë, domethonë, në nivelin ma t'lartë që na kanë shërby edhe neve për me ngrit ni ideal t'pastërt.

Kur, në vitet '90 më duket është formu Lidhja Demokratike, po, këto vite. Unë para kësaj, ka qenë "Për Demokraci kundër Dhunës," nifar' hulumtim, s'e di a hulumtim a çka ka qenë ajo, osht' lansu nga Veton Surroi edhe osht' shpërnda nëpër qytete. Unë e kom marrë ata, kom marrë shumë ekzemplarë, m'i plotësu domethonë, me njerëz. Kjo ish m'i hapë rrugën pastaj për me regjistru njerëzit te lëvizja demokratike.

M'kujtohet me ni shoqe timen në Has, kjo zona kah Prizreni domethonë. Duke u futur n'shpi më shpi na kish zonë nata. Tash s'kishim me çka me shku n'qytet. Ni makinë e fshatit na përcolli po ai e kish pasë ni sakicë, sëpatë, e kish pasë në kerr. Ato materialet që na teprun, i futëm nër' sedilje të makinës se e dishim që post blloku ish aty, kah kishim me kalu na, post blloku i policisë. Tash, sakicën, sëpatën s'kishim qysh m'i largu se ata veç e panë.

Aty domethonë ish rrezik që me na marrë po e morën vetëm pronarin e makinës të cilin e lshun pas 24 orëve se ai u arsyetu që kjo ka qenë, unë baj dru... nejse, qysh ka ditë m'u arsyetu ai. E patën lshu. Ai erdh me na bo mirë neve, e thojsha, p'e bjen viktimë e jona. M'kujtohet na kanë lanë domethonë me pritë aty t'u na marrë n'pytje deri kur ka zbardhë. Unë, shoqja jeme edhe pronari i makinës. Kur e morën ata, me gjithë makinë domethonë, se nuk e futën n'makinë t'vetën po na lshun në qytet, e ata e morën me gjithë makinë. Makinën e lanë jashtë policisë.

Tash na i shishim dritat a u nalen te policia a jo, se në qoftëse i kanë nalë domethonë e kanë nalë edhe marrjen n'pytje ose torturën. Dikur u nalën dritat edhe na shkum, domethonë, na shkoj nata duke përcjellë situatën. Ktu n'shpi alarmi, gjithë natën pa shku na. Me mu ishin msu po familja e asaj shoqes... i thashë, "Sonte ki me flejt te une në mënyrë që nesër ju thojmë që kom nejt te unë, kam flejtë", për me kalu ajo pak ma lehtë. Pas kësaj domethonë, tash na u futshim nëpër shpija t'u i regjistru njerëzit në lëvizjen demokratike.

Qata e qitshim ma s'pari për demokraci kundër dhunës. Nashta keni ni me ata çelsat që bojshim nëpër ballkona. U konë edhe qiky hulumtim. Njerëzit me t'madhe fillun m'u regjistru në lëvizjen demokratike. Atë ditë kur u formu në Gjakovë unë isha në msim. Se u formu paradite, isha në msim edhe ish ni brengë e madhe për mu që s'qëllova po megjithatë ma vonë u inkuadrova. U regjistrova meniherë edhe u zgjodha anëtare e kryesisë së Forumit të Gruas të lëvizjes demokratike për Gjakovë. M'u caktu pjesa e kulturës.

Dihet që çdo gja kish pushu këto vite edhe kultura edhe aktivitetet e ndryshme. Prandaj, u munoshim përmes forumit me organizu tema të ndryshme që kishin t'bëjnë me kulturën. Kur isha në Shqipëri pata marrë libra, që m'i qitën ilegalisht dy nxansa t'mi, që ishin të zonës kufitare. Unë i lash në Kukës dy thasë me libra e ata m'i kishin qit' ilegalisht, nga mali, n'shpi t'vet e pastaj kapak kapak domethonë i bajsha, i çojsha n'shpi. Tash domethonë, me ato libra ishin domethonë shënime që na mungojshin neve. Historiku i shkollës t'parë shqipe, na kishim veç pak t'dhana, aty ish libër i tanë.

Kishim shumë, morëm shumë material që mu m'shërbej pastaj te komisioni i kulturës. Po në ndërkohë ne shkonim edhe nëpër familje t'burgosurve, të njerëzve që ju kishin vra djemtë në ushtri, nëpër burgje. Pastaj, shkonim te nënat vet ushqyese për t'i ndihmuar. Kemi ndihmu me t'holla që i mbledhshim nëpër qytet, kemi ndihmu me pako ushqimore dhe higjienike. M'kujtohet në Suharekë edhe në Drenicë kemi shku forumi i gruas edhe kemi çu ndihma. Suhareka pat' vërshime edhe e psun shumë keq. Ndoshta ndihmë simbolike po megjithatë jemi mundu diçka me bo.

Në këtë kohë, më caktuan që të shkoj në Shqipëri sepse grupi i t'burgosurve politik të Gjakovës mbaheshin domethonë padrejtësisht, dihet, për ni parollë, për ni sen. Më orientuan te Pjetër Arbnori, ish atëherë kryetar i kuvendit. Kur shkova në Tiranë më pranunë, domethonë, pa problem. Ju thashë që... Shqipëria e ka pasë ni emision, Radio Tirana, për bashkëatdhetarë. Aty e ndëgjojmë domethonë edhe shtetet tjera sepse jepshin edhe n'gjuhë tjera. E bom ni kërkesë për lirim e t'burgosurve politik.

Meniherë pas kësaj, pasi që dul emisioni edhe Pjetër Arbnori me ato rrugët e veta u lirun disa të burgosur politik të Gjakovës. Unë e bëra në përgjithësi por, ndoshta janë liru edhe tjetër, por unë kisha marrë informacion për këta. Kështu vazhdun disa vjet me shoqet e forumit. Ishin t'burgosur, zakonisht mas demonstrative të '81-shit domethonë njerëz që ishin dënu 15 vite, 14, 11.

Një ndër ta ish edhe bashkëshorti im, ish dënu 15 vite. Motra e tij ka qenë anëtare e forumit të gruas, ka qenë edhe ajo aktiviste. Më ka ndihmu shumë për ndihma me ju ofru njerëzve. Pas kësaj, domethonë, fillon ni periudhë tjetër. Ni periudhë noshta ma e vështira e krejt jetës sime, përgatitja për shelimin kombëtar.

Anita Susuri: Fillimisht po du me ju... para se t'dalim andej te vitet ma vonshme. E përmendët bashkëshortin e juj edhe ai ka qenë ish i burgosur politik. Si ka ndodhë që me u bashku ju? Tregut për motren e tij po si keni vendosë me qenë bashkë?

Sakibe Doli: Në kohën kur ai ka qenë n'burg ka pasë nxansa t'mi që kanë qenë ushtar që kanë ra n'burg. Ndoshta ju kujtohet ajo i Paraqinit ai rasti,⁴ që e vran ni t'ri. Ata kanë zanë, ata pa shkas i kanë vra ushtarët. Po tash edhe ni nxans i jemi ka ra n'burg aty. Kanë qenë bashkë me Mislimin. Ai u lshu ma

⁴ Rasti i Paraqinit i referohet incidentit tragjik të ndodhur më 3 shtator 1987 në kazermën e Paraqinit, ku ushtari shqiptar Aziz Kelmendi vrau katër ushtarë dhe plagosi pesë përpara se të ekzekutohej nga autoritetet ushtarake jugosllave, një ngjarje e qëllimshme për të justifikuar represionin ndaj rekrutëve shqiptarë dhe që u shoqërua me një proces politik të montuar.

herët se ka qenë i dënun ma pak. Ma kish çu ni shenjë domethonë. Kështu motra e tij fillun domethonë komunikimin ma t'shpeshhtë edhe kjo kishte dy vllazën. Këta të gjithë kanë qenë t'burgosur politik, pesë, por ma vonë ka qenë Mislimi edhe Sokoli.

Kryesues i shtabit të përgjithshëm, domethonë, të gjykatës ushtarake ka qenë gjatë luftës. Sokoli para se me fillu këto organizimet për shkrimin kombëtarë e kishin formu ni grup që ta formojnë ushtrinë. Ktu... atëherë unë u angazhova vetëm për këto emblemat të ushtrisë. I qenissha. Thirrsha plot shoqe me më ndihmu, gjojshin arsyetime. Kom punu me ni shoqe tjetër sa kom mujtë domethonë për m'ju bo uniformat e ushtrisë. U zu burgu dhe Sokoli ra n'burg domethonë. Tash ish Sokoli edhe Mislimi, te dytë.

Pas, pastaj Mislimi lshohet në '94-ten, ma vonë lshohet nga burgi. Para kësaj domethonë në lëvizjen demokratike kishin fillu aktivitete të ndryshme. Regjistrimi i popullsisë, që kom marrë pjesë, shumë kom punu. Formimi i degëve të lëvizjes demokratike nëpër çdo lagje të Gjakovës edhe fshatrat e Gjakovës. Unë kom marrë pjesë në formimin e degës dy, katër edhe shtatë. Degët ma t'mdhaja të qytetit. Diku kom qenë kryesuese, diku... po organizimi, sidomos gratë janë organizu shumë. Kjo ish, festë bre festë. Unë e ndisha si festë qaq shumë organizojshin, merrshin pjesë nëpër mbledhje.

Ajo që m'ka lanë ma së shumti përshtypje është organizimi i degëve të forumit të gruas në fshatra. Unë... odat e mdhaja të fshatrave, ju i dini, s'paku keni dëgju. Ka pasë rast që kah 200 gra të fshatit, nashta deri dje veç te kojshia janë dalë, u mbledhshin nëpër oda edhe i trajtojshin problemet personale që kishin për shkak të fëmive të tyne po edhe nevojat e përditshme. Për shembull, ni nanë nëse i kish gjashtë djem, ajo e kish hall se u duhke me pagu pare për m'i siguru gjashtë nuse.

Me, domethonë, me këto mbledhje ato gratë vendosen që ma kjo mos me u jetësu, mos me funksionu. Këto mos me pagu pare për me marrë vajza, m'i martu djemtë me para. Domethonë krahas luftës për liri u bojke edhe ngritja sociale e njerëzve, domethonë, për me ia lehtësu vetit jetën. Sepse nëse i ki gjashtë djem ti sa parja u duhke m'u japë për me zanë nuse. Plus pastaj çka duhet tani ato ari e sene. Domethonë kjo ish që gratë i bashkojke. Mos t'flasim pastaj për parullat që i flitshin gratë.

M'kujtohet niherë isha t'u kthy sepse prej fshatit autobusi shkojke, ka pasë dy herë gjatë ditës... në qoftëse t'ka kalu koha e autobusit ti u dufshe me prit t'mramjes. Isha t'u u kthy n'kamë, 12 kilometra. Post blloku i policisë ishte si t'dilsh n'rrugë kryesore. Aty i kisha t'shkrune krejt çka kanë folë gratë, parullat, "Kosova Republikë", "Pavarësi". Gjithçka çka thojshin ato unë i shkrujsha për m'i dërgu në Radio Gjakovë. Radio Gjakova pastaj i transmetojke derisa e nalën krejt.

M'tha, "Hape çantën", tash ish policia serbe. E hapa çantën, nuk, nuk i kuptojke, republikë e kuptoj. I thashë, "Hartim i nxansave". Ma shtyni çantën me kondak edhe tha... m'i gjujti ato n'tokë edhe m'tha, "Mbledhi këto edhe ik". I mora kadale edhe nuk ish kurgjo ajo n'krahassim me çka ka mujtë me ndodhë. Domethonë ky entuziazmi i grave të fshatit ma jepke shpresën që ky popull shpejt ka me fitu lirinë.

Pastaj edhe në Gjakovë kur u organizu krejt lëvizja demokratike filloj ajo për arsim. Se u mshelën shkollat, na qitën prej shkollave n'rrugë edhe na u organizum nëpër shpija.

Kjo kërkonte punë, organizim. Nëpër xhami që u bonë shkolla. Pastaj, gjimnazi... shkollën fillore nuk e patën mshelë, Mustafa Bakija, vetëm shkollat e mesme i patën largu prej ndërtesave edhe na majshim msim ni kohë. Se mandej na qitën edhe prej atyhit. Majshim msim aty. Aty u munojshim kah pak me... m'kujtohet i pata organizu garat e diturisë. Garat e diturisë n'qato kushte domethonë, nashta policia na përcjellshin e rujsin po nuk u nalshim. Nuk ish, s'kish arsye m'u ndalë, u dufke me punu shumë.

Kështu pas regjistrimit të popullsisë erdhën ndihma për mësimdhënës, kah 40 euro që u dufke me shku shpi n'shpi me mbledhë para. M'kujtohet ni djalë që nuk kishte fëmi t'vetin edhe po i thotë nanës t'vet, "Nanë shpejt qiti paret", "Për çka?" Tha, "nanë?" "Për fëmitë", tha, "m'u shkollu, msust m'i pagu", "Po ti", tha, "s'ki fëmi", tha, "Ani mos paqa unë kanë tjetër". Ata ishin n'gjendje shumë t'vështirë ekonomike. Nana vet... unë e kuptojsha edhe nuk dojsa m'u nalë aty ma. Po ai insistojke që unë m'i pritë paret derisa t'i qet' nana e atij.

Janë disa skena e disa ngjarje t'vogla që ty t'lajnë mbresë edhe qe pas kaq vitesh nuk e kom harru. Se domethonë e sheh që populli ka reflektu edhe e ka kuptu domethonë çka osht' pushteti i egër edhe çka osht' nevoja për liri, arsimim edhe kulturë. U kry edhe kjo domethonë edhe kur i krym, i evidentum familjet, u mbledhshim paret pastaj muj për muj... arsimtarët, jo t'gjithë nuk kanë marrë t'holla. Unë edhe vllai im ishim te dytë n'arsim, nuk kemi marrë se ne në ndërkohë e patëm hapë ni biznes te familja babës edhe na premtojke. Sepse të gjithë i largun prej punave, me qat' biznes pastaj na mundëm me jetu edhe u deklarum që s'kishim nevojë për t'holla në arsim.

Shkolla ka vazhdu normalisht. Shkojshim shpi më shpi. Interesant në qoftëse n'shkollë ka pasë ndonjë mungesë, nëpër shpi shkolla nxanësit ishin të gjithë prezent. U shtu ajo revolta sepse e dijmë që arsimi është ni armë e fortë kundër pushtetit. U vetëdijësun edhe nxansat edhe arsimtarët, nuk kish mungesa, s'kishim kah me lëvizë shkollë nëpër shpija. Edhe njerëzit e shtëpijave na kanë pritë mirë. Mësimi, unë mendoj, që është zhvillu normalisht. Nashta na kanë mungu mjetet mësimore por na kemi dhanë maksimumim. Nxansat kanë qenë në gjendjen e duhur për t'i marrë ato informacione.

Koha kalonte edhe në vitet e '92-'93 veç fillun domethonë faza tjetër. '94 u liru Mislimi nga burgu edhe u martum meniherë. Unë menojsa që e ka maru karrierën e vet deri qitu ma thojsha mjaft. Ish shumë i dobët, kish hupë shumë n'burgje. M'tregojshin shoktë, se ky kurrë s'ka folë, ma shumë ka nejt në qeli, e kanë obligu se ky me dëshirë s'ka nejt, por ma shumë ka nejt në qeli e kanë obligu sesa ka nejt ktu me njerëz tjerë. Ka pasë ni njeri me karakter shumë t'fortë që unë te pak kush e kam gjetë.

Atëherë menova që ky tash duhet me pushu edhe me punu tjetër. Por si ka ardhë domethonë ka fillu me mbledhë para për armë. Familja ime atëherë ishte ma mirë ekonomikisht edhe m'kanë ndihmu

shpesh. Oshet' ble automati i parë domethonë, kjo ka qenë festë. Na nuk kemi bo gjumë të rehatshëm sepse na vijshin edhe shokë, vijke edhe Sokoli.

U dufshim me qenë gjithmonë... se duke qenë familje me t'burgosur politik ata ishin n'sy t'pushtetit, ishin t'përcjellur të gjithë. Dilke njani hike tjetri. Bile m'kujtohet niherë kur u liru njani prej kunetëve tha, kunat i madh tha, "Çka dojna me bo more jena msu nëpër burgje me shku. Tash çka bojmë na?" (qeshë).

Anita Susuri: E bashkëshorti ju j n'cilin vend ka qenë n'burg? N'cilin burg ka qenë?

Sakibe Doli: Fillimisht e kanë marrë në Prishtinë pas Prishtinës e kanë çu në Prizren. Gjykimin ia kanë bo në Pejë. Prej Pejës e kanë çu në Nish e aty në Nish tani Përkuple e çka janë do vende qaty e kanë shëtitë po ma së shumti në Nish. Kanë qenë tortura shumë t'mdhaja e vetëm Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, që Vjosa Dobruna është aktiviste për të drejtat njeriut, axhë e ka. Ajo ka arritë m'i çu Kryqin e Kuq vizita nëpër burgje. M'i bind me shku ndërkombëtarët.

"Pas kësaj vizite", thotë, "pak, filloj pak ndryshe burgu. Gardianët u sillshin pak ma ndryshe". Sepse deri atëherë kur s'kanë pasë asni kontrollë nga jashtë, t'burgosurit i kanë dhunu së tepërmi. Veç qatëherë ka fillu domethonë ni frymë tjetër...

Anita Susuri: E ju a keni pasë rast me vizitu apo me shku?

Sakibe Doli: Jo, duhej veç familjarët. Unë kom shku me shoqen time me vizitu babën e vet në Burg të Nishit. Nuk kom pasë t'drejtë me hy se ata veç mbiemrin e lypshin. Por, e kam pa nga jashtë domethonë. E kam shoqëru disa herë në Burg të Nishit. Sepse edhe ajo e ka pasë babën. Kemi qenë shoqe edhe t'punës edhe të fëmijërisë edhe t'grupit. E s'mujsha kaniherë me lanë vetëm. Se nana e vet ish me ndrrime, nga msuese e kishin largu e kishin fut me ni fabrikë. Ajo kur kish me ndrrime domethonë. Kur kish ajo, kur nuk kish mundësi e shoqnojsa unë.

Anita Susuri: Domethonë ju prej larg e keni pa bashkëshortin a?

Sakibe Doli: Jo, babën e asaj. Bashkëshortin hiç se ata i kanë pasë me orare.

Pjesa e Tretë

Sakibe Doli: Pastaj, domethonë, filloj përgatitja për luftë. Në '97-shin kur dul UÇK-ja në skenë, '97 ishte apo?

Anita Susuri: Po.

Sakibe Doli: Kishim ndëgjju po apet nuk bindeshim që osht' e vërtetë. Pas kësaj shkum në Drenicë, forumi i grus shkoj në Drenicë për m'u bindë që ushtria ekziston por rrugës na nalën. Na nalën në polici, domethonë, ishim dhetë veta. "Ku po shkoni?" Na thoshim, "Po shkojmë në Prishtinë", u munojshim m'u arsyetu. Na nalën s'disa orë. Shkum. Pas kësaj kur ndodhi në Qirez që u bon vrasjet e para,⁵ unë kisha marrë disa t'holla për m'i ndihmu qato nana që psun, që u vranë njerëzit nga serbët.

I vizitum qato familje po, ha, tash nuk shkum ma nga rruga po ni shok i burrit i burgosur politik nga Malisheva na orientoj nga mali. Shkum pa problem. I vizitum familjet edhe e takum Jakup Krasniqin. Aty u bindëm që ushtria ekziston edhe u kthym në mramje vonë po nga qajo rrugë. Se ushtria e kish bo ni rrugë për me lëvizë ma lirshëm. Ni shoqe e jona na tha që, ni furrë buke e ka çu atje te ushtria. Atëherë u bindëm që ushtria ekziston.

U kthym edhe meniherë pas kësaj plasi ngjarja në Glogjan. Burri im, shpija jonë kur erdha unë nga Drenica po ju tregoj, po ju tregoj. Djali i kunatit ish maturant, sa e kishin kry me shokët e vet. Ishin nxansa t'mi, ishin ni grup i mirë i shokëve. Grup që ishin marrë me muzikë, me modë, me reklama, me... edhe tash ata menojsa që ata kurrë për luftën s'ka m'ju shku menja. Ata ishin kanë t'u më ngu mu. Ky Leka t'u më ngu mu për m'ju shpjegu pastaj shokëve.

I shihsha çdo natë në garazhë u mbledhshin. Thojsha, pse në garazhë këta gjithmonë janë hypë nelt, pse tash këta ktu. T'u bo plane këta qysh me bo aktivitete në qytet. Veç kur kanë shku n'luftë e kom kuptu që këta paskan pasë tjera probleme e nuk është ajo që kom menu une. Shkun këta, pas ngjarjes në Glogjan,⁶ Mislimi shkoj me ni makinë me shokë edhe u regjistru meniherë në UÇK. Ishin katër vet t'parët që shkun i kanë pranë edhe janë kthy.

Mujt e parë kanë punu në logjistikë me çu ndihma, ushqime, veshmbathje. Ktu u angazhun edhe vllaznit e mi. Sepse aty u dufshin me bo kreveta për ushtarë, u dufshin... shumë punë ka pasë m'u bo, m'u organizu. Çojshin ushqime për çdo natë, nuk u ktheshin. Unë çdo natë e kom zbardhë n'dritare t'u pritë derisa kthehen. Ka qenë rrezik shumë. Filloj, domethonë, pas ngjarjes që i vranë ata t'parët në Gllloxhan, filloj m'u organizu ushtria me t'madhe.

Nuk ka pasë t'ri n'qytet që nuk kanë ardhë n'shpi me vet, "A na çon baca Mislim n'luftë?" Ka qenë përgjegjësi e madhe. Ka qenë djem t'vetëm që lypshin me shku. Sepse gjithë ajo dhunë, s'kishin ku me dalë t'ritë se meniherë ja ushtrojshin dhunë ja i merrshin n'biseda informative, ja i burgosshin pa arsye

⁵ Më 28 janar, 1998 në fshatin Qirez, komunë e Skenderajt, forcat policore dhe ushtarake serbe vranë disa banorë shqiptarë, përfshirë anëtarë të familjeve Ahmeti dhe Sejdiu. Ky ishte një nga incidentet e para të përgjakshme në Drenicë që shënoi fillimin e përbaljes së armatosur mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe forcave serbe.

⁶ Më 24 mars 1998 në fshatin Glogjan, komunë e Deçanit, forcat serbe rrethuan zonën dhe u përleshën me njësitë e UÇK-së të udhëhequra nga Ramush Haradinaj. Gjatë luftimeve u vranë disa pjesëtarë të UÇK-së dhe civilë shqiptarë, ndërsa ngjarja u bë një nga betejat e para të hapura të luftës në Dukagjin, duke nxitur mobilizimin e mëtejshëm të banorëve lokalë.

derisa u ngulfat ma. Ju erdh, jeta s'kish ma vlerë. Për këtë arsye këta donin m'u organizu se nuk durohej ma kjo dhunë policore e egër që unë as nëpër filma nuk kom pa çka kemi përjetu na Kosova, shqiptartë e Kosovës.

Dikond që e kishe ma t'afërt mujshe me orientu pak mirëpo shumicës i thojshim, "Kush don e gjon rrugën vet, organizohet dy-tre shokë". Kështu u bajt qyteti në Gllogjan e në Jabllanicë t'ritë e t'reja. T'reja ka pasë ma pak po shkun shumë. Dijmë që '98-ta ka shpërthyer nëpër fshatra. Erdhën njerëzit nga fshati m'u strehu. Digjeshin fshatrat edhe vishin në qytet. Ktu jom angazhu domethonë m'i strehu ni pjesë të banorëve të fshatrave m'i strehu nëpër qytet. Qyteti i ka hapë dyrtë për m'i strehu ata se ishin mbetë pa kulm m'i kry. Me njerëz t'vran besa. Pa asni mundësi jetese.

Kështu domethonë janë strehu edhe janë akomodu shumica e njerëzve nga fshatrat që s'kanë pasë kulmb mbi kry. Në t'njejtën kohë Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Prishtinë i ka identifikuar disa nëna që iu kanë vra burrat në luftë. Ato e krijuan ni strehimore në Gjakovë. Ni shpi t'madhe e morën, na dhanë ni familje, ata jetojshin në Prishtinë. Aty u strehun gjashtë, pesë nëna me 21 fëmi. Ju kishin vra burrat, ju kishin kallë shpijat edhe ishin mbetë rrugëve.

Unë bashkë me ni shoqe time, Kutlije Maloku, jemi kujdesë domethonë në '98 për ato nana. Por, na ka ndihmi Nënë Tereza që t'i mbajmë me ushqim. Pastaj edhe i përkrahshim, kshillime psiko-sociale. Sepse nuk e kishin t'lehtë. Ishin mbetë të vetme me ton ata fëmi. Dikush e kish, njana i ka pasë dhetë, tjetra katër, domethonë, kështu. Krahës kësaj e kemi hapë edhe një zyre ilegale për me mbledhë armatim për m'i formu ni shtab të ushtrisë në Gjakovë. Sepse thashë, meqenëse zonë kufitare ata kaniherë kur i numrojsa tankset thojsha krejt Jugosllavia ka ardhë në Gjakovë.

Ish e nevojshme që t'organizohet edhe qyteti. Pesë veta ishim n'atë grup, një ndër ta isha edhe unë. Por, Mislimi pasi që u rreziku duke shku në Gllozhan, Gjakovë. Duke lëvizë, t'u çu ndihma atëherë ai u ndal atje edhe e murr armën për me iu bashkangjitë ushtrisë. Tashti na në Gjakovë fillim me pyetë a ka dikush armë m'i forëzu vullnetarisht në shtab, n'qat' zyre se s'muj me qytet shtab. Për me pasë ni armatim që kur t'shpërthen në qytet me qenë sado pak të përgatitun. Mbledhshim t'holla edhe armë.

Armë shumë pak kish e hiç. Ish shumë rrezik. Punojshim në ilegalitet t'plotë. Në ndërkohë Mislimi m'thirrke, se telefoni ajror ka punu n'ushtri, e m'thirrke, "Bir", qit' mjek, "se ka t'plagosun". Nuk flejsa me natë të tana. Qysh me shku m'i thanë, osht' rrezik, mundet m'u vra, a p'e din? Po u dasa, ni detyrë kur t'ma jep u dasa me kry se s'bon. Kështu që unë fillova me çu mjek, me çu teknik medicinal, me çu ushtarë edhe u bo kjo si përditshmëri.

Ma shumë lëvizjet i bojsha t'shtune, t'dielle kur nuk kishim msim. Kur u nal shkolla masnej shkova ma gjatë. Po derisa isha n'shollë kisha kujdes se ni ditë me mungu ata meniherë m'kapshin domethonë, e merrshin, e kuptojshin. Gjatë shkollës m'kujtohet ni nxanës gjatë msimit m'tha, "Msuse, sot ia kemi, dje", tha, "ia kemi kallë ni tankë armikut", klasës t'dhetë. I thashë, "Pse po m'i thu mu këto?" Tha,

“Msuse se ti je patriote”, (qeshë), “Kush t’ka thonë?” Tha, “Po unë e kom kuptu vet prej shembujve që i merr ti”.

Tashti unë nuk e zisha besë tanksen me kallë edhe t’nesërmen n’mëngjes e kom hupë edhe msimin edhe jom nisë me ni gru t’qatij rajoni që ish strehu në lagjen tonë. Jemi shku. Taksit kishin frikë me ardhë te UÇK-ja po u nalshin te ni urë ka t’vini kah Prishtina te Kramoviki është qajo ura. Na pastaj vazhdojshim n’kamë. Shkum edhe me t’vërtetë e pashë tanksen e djegun edhe m’u bo qefi. Thashë, t’kishin me ndodhë ma shumë.

Dy herë Glloxhani u djeg i tëri, dy herë. Ofensivë shumë t’rreptë. Ka pasë vrasje. Vajza e kunatit Vjosa që thashë, ka shku, erdhi në Gjakovë i mori disa ndihma medicinale që i kishin mbledhë. Edhe e kish kamionin me ndihma ushqimore edhe shkoj në fshat, në Glloxhan ku ishin këta a në Jabllanicë, nuk jom bash e sigurt. I ka dorëzu ato po n’mramje kur u kthy p’e merr n’telefon p’e thotë, “Sakibe, Ilir Sobën e kishin vra”, ni arsimtar nga Gjakova, ni muzikant, ni gitarist shumë i njohur. “Xhaxhi”, tha, “ish plagos”.

Nuk m’u dokë plaga shumë rrezik sa kur ma dha lajmin për Ilir Sobën. Aty ishin vra edhe shumë njerëz tjerë po këta i ngjike edhe m’tha. Prej asaj kohe nuk kom nejt ma, s’kom mujtë me nejt e qetë. Jom shku rregullisht. Kur kom mujtë m’u kthy jom kthy, kur s’kom mujtë kom nejt atje n’ushtri. Se kisha nevojë me shku m’i thirrë dikon, m’i çu. Naj detyrë që ma jepshin u dufsha me kry gjithsesi. Tash Mislimi e kish kriju ni spital me disa shokë, t’improvizun ni spital sepse pas ofensivave kish t’plagosur shumë. Kish nevojë për gjak, kish nevojë për mjete medicinale.

Ktu kemi kontribu pak po edhe ndihma me ushqime, veshmbathje sepse e kisha ni shoqe na Adra Internacionale. Adra ish ni shoqatë ndërkombëtare me ni t’hujën që ju thojsha, “Ndihamat për fshat janë për fshat”, por aty ish edhe UÇK-ja. Ato m’kanë ndihmu në fillim edhe deri kur u ba e pamundur ma me lëvizë sepse pas dy ofensivave policia ish egërsu tepër edhe nuk majshe ma me depërtu aty. Me kalu domethonë qat’ urën për me shku në Jabllanicë edhe në Glloxhan.

Anita Susuri: Po du me ju pytë, n’fillim domethonë në mars, ka qenë rasti që ka ndodhë te familja Jashari, e di që grupi i forumit të grave kanë shku, kanë qenë të pranishme. A keni shku edhe ju?

Sakibe Doli: Jo. Unë s’kam qenë. Na kemi qenë ma përpara n’familjen Jashari. Kojshi Jasharajve janë konë këta, edhe këta atdhetarët që për momentin s’po m’kujtohet emri. Dy vajzave të asaj familje ju patën shem policia shpinë. Ata i patën vra e këto çikat kishin nevojë për m’u shkollu. Gjakova ju siguroj bursat. Na tash aty s’kishim ku me nejt u futëm te familja Jashari derisa bisedum për me ju ndihmu bursat nga Gjakova me ju japë atyne dy çikave për m’u shkollu, në Prishtinë domethonë. E atëherë nuk kom qenë unë, Vjosa ka qenë. Ajo aktiviteti me bukë që ke bo gratë që shkojshin. Pastaj forumi... ato janë shku se ma afër Prishtina, na nuk kemi pasë mundësi qatëherë me shku.

Anita Susuri: A jeni organizu për me shku?

Sakibe Doli: Jemi organizu si forum po nuk kemi mujtë. Mungesa domethonë e transportit ke ndodhë qatëherë. Nuk e di pse. Nuk e di pse që na s'patëm mujtë m'u bashkangjitë. M'kujtohet ni moment që jom ni e ligshume, n'atë ditë ish djegë ni pjesë e Rekës të Keqe. Domethonë policia kish vra e kish djegë fshatin edhe tash fshatarët ishin t'u largu nga fshati edhe vijshin në ni lagje të Gjakovës, në dalje kah Peja.

Unë atë ditë e përcillsha Mislimin i cili kishte ardhë ilegalisht nga fronti në Gjakovë për t'sjellë armë. E kishte lidhë në bicikletë tre automatik edhe kishte ardhë në shpinë time, te familja ime. Kishte sjellë armë edhe atë natë ish rrezik m'u kthy e nalëm me flejt aty edhe t'nesërmen kish m'u nisë prap për front, për Jabllanicë. Tashti dita që fshatarët vishin në lagjen e Gjakovës ish dita që Mislimi u dufke me shku atje.

Nuk e dishim na çka ka ndodhë, krejt policia n'kamë edhe kish ardhë ni gjeneral i lartë jugosllav, kish ardhë në Gjakovë në vizitë në kuvendin e komunës. Çdo rrugë, çdo rrugicë kishte post bllok. Mislimi ish n'atë listën e zezë që i kishin qit' 100 vet nga Gjakova edhe thojsha si t'ia marrin lejën e identifikojnë. Ata rrishin me atë list në çdo post bllok. Aty e kom pa vetën që m'ka lshu forca.

I kom, e kom marrë vllaun tim edhe dy vajzat e axhës, ato me na hapë rrugën përpara edhe na me makinë. Mislimi i shtrim përmapa. Ni ktu {tek beli} e ka pasë me bomba edhe fishek edhe jemi, kemi shku rrugës. Na ka nalë policia pak pa hi n'lagje. Janë dalë këto dyja edhe kanë folë me ata edhe na kemi kalu. Kur jemi shku te qajo familja që u dufshim m'i prit derisa të erret, fshatarët veç vishin.

Gratë ishin, e kishin hupë domethonë, ishin traumatizu, ishin stresu nga ato që kanë pa në kah zona e Rekës të Keqe. Domethonë i kanë lanë edhe njerëzit e vranë e me fëmi t'u u largu. Kjo e shtoj edhe ma shumë pastaj ligshutinë time. M'lshoj trupi. Mislimin e futën në ni dhomë me pushu, unë as nuk mujsha me folë, as, nuk e di. Shumë vetën e kom pa të ligshune atë ditë. Kur u err, me ni çikë të asaj lagjes e kemi përcjellë deri, nja pesë kilometra pa shku në Dujakë. Është fshati ma i afërt me qat' lagje.

E kemi lshu me shku. Na u kthym. Policia veç ish qetësu. Natën nuk lëvizsshin shumë. U kthym na te ajo familje. Kur tash pas nja dy orëve u lajmëru Mislimi n'telefon që mrrijta mirë. Se edhe aty ka pasë ni shtab t'vogël. Megjithatë domethonë m'vyjke kohë me marrë forcën prap. Pas asaj Dujakës ka shku pastaj atje. Se i kanë pasë rrugët e veta pastaj ushtria kah me shku. Ni moment që e kom nda edhe me disa intervista tjera, unë për me shku shkojsha lehtë, për m'u kthy prej zonave t'luftës në Gjakovë ka qenë tmerr, shumë e vështirë.

Policia gjithmonë ka bo roje. Ushtria, UÇK-ja. Unë s'e kom ditë. Jom kthy vetëm si zakonisht kisha me dalë me zbritë n'rrugë për me dalë me prit naj autobus a diçka për m'u kthy në Gjakovë. Nuk isha e re, isha pak ma e moshune edhe nuk e kisha shumë, nuk, dyshime, nuk bojsha shumë dyshime te policia.

Po megjithatë veni u konë, zbritsha edhe pritsha m'u kthy në Gjakovë ish pak e dyshimt se ata e dishin ku janë zonat luftës. Policia e ka ditë.

Eca, eca n'kamë kur po dal, hala pa dalë naltë kështu n'rrugë po e shoh ni autokolone të makinerisë serbe t'u zbrit qasaj rruge që kisha me ardhë une. Edhe aty domethonë ka qenë rasti i dytë që unë jom ni keq. Po m'thotë ushtarët e UÇK-së po m'thojnë, "Mos e kthe kokën, mos u frikëso". I kishin qit' dy zona, degë të drunjëve edhe, "Mos ki frikë se në qoftëse ata t'nalin na reagojmë". Po instiktivisht e ktheva krytë edhe lot fillun me m'dalë. Domethonë pak nga dhimbja pak nga gzimi që ushtria domethonë osht' kaq e zoja domethonë m'i sulmu auto kolonën.

Auto kolona duke ditë që aty ka ushtri, i jepke me tanë fuqinë që kish. Kalova pa asni problem. Po kur shkova n'shpi emocionet m'kaplun edhe shpërtheva n'vaj, s'mujsha me folë. Ishin edhe lot gzimi edhe lot dhimbjeje, shkoj edhe kjo. Pas kësaj, ushtarët kishin vendosë që m'i hapë pikën në Gjakovë. Tash na kishim mbledhë shumë pak mjete materiale edhe u vendosën në Lagjen e Çabratit. U formu brigada 137 Gjakova.

Gjatë kësaj kohe sa unë isha, domethonë, u kujdessha për pleq, për fëmi, i hapshim këto muret për me... kur ishim n'rrezik kjo ana me dalë kah ana tjetër, u djegshin shpija, ish tmerr. Kur u formu brigada, u luftu tri ditë e tri netë në Çabrat. Kemi pasë t'vran edhe t'plagosun. Unë prap çojsha ushqime, me logjistikë edhe tash bisha n'sy. U dufta m'u largu kur u largu brigada. U vendosëm në Dobrosh shkova edhe unë atje.

Osht' nata e parë që kisha flejt pas tre mujve. Sepse isha ma e sigurt, isha n'mal, kishe ushtrinë. Ndryshe ish atje, ndryshe ish n'qytet se veç pritshe kur po t'vrajnë, kur p t'djegin. Edhe aty u angazhova për ndihmë ushtrisë jo me mushë ujë për ushtrinë, jo mjaltë kemi nxjerrë. Sepse fshati ish i bosatisur edhe bletë, kurrë ma shumë, se unë kom pasë bletë, kurrë ma shumë mjaltë e ma pastër s'kom pa.

Ushtria na hapte rrugën normalisht se kish mbeturina të policisë, kishin vendosë edhe ksi bombë, mina. Mina nëpër rrugë. Se i shishim vendet po ata ma së pari e verifikojshin terenin, e hapshin rrugën edhe shkojshim na. Me djaln e tezës se edhe ai ish ushtarë bile i plagosur në Çabrat. Natën kur u bo marrëveshja po m'thotë Mislimi, "Ti duhesh me shku sonte me ni grup të ushtarëve me pregatit terenin për nesër", se kish me hi ushtria n'qytet.

Kisha qef me ardhë me Muslimin edhe me ushtrinë po megjithatë urdhëri urdhër edhe u dufsha me ardhë. Kur jemi ardhë Çabratin nuk e kom njoftë. Shpijat ishin djegë. Na ecshim nëpër mure t'shpijave. I kishin djegë muret, kulmet ishin ra poshtë. Krejt shkrum. Kishin masakru, kishin vra njerëz. Masakra shumë t'mdhaja kishin bo në Gjakovë. I kisha nga Çabrati që është lagje e naltë i shihsha tankset t'u shku kah Peja. Thojsha a janë tankse të KFOR-it a janë të policisë. Si do që t'jetë thojsha kokan t'u u largu.

Erdhëm. Shtabi i qytetit ish në bllok t'ri edhe shkum. Atje i kisha dy vllazërit e mi. Shpija e babës ish n'qit' pjesën e qytetit ma naltë domethonë. Blloku i ri është qitu ku jemi na qitash. Nuk flejta atë natë. Mëngjes m'thojshin, "Rri sa t'zbardhet mirë", "Veç du me shku te shpija babës". Se shpijen tonë na kishin kallë natën e parë të bombardimeve policia serbe. Shpinë e Muslimit. Shpija te baba kish pshtu se kom pasë biblioteke t'madhe t'librave. Shpesh herë i kanë marrë i kanë qit' në podruma te kojshitë, i kanë kthy n'shpi se s'dishin kush po kallet edhe m'i kanë rujtë librat.

Atë natë domethonë, atë ditë në mëngjes herët, kish hala mbeturina të ktyne policëve serb. Hyjmë na të nesrit e pashë ni kamion me polic edhe fillun me shajtë, fillun... kriminela. U fsheha pas ni muri. Ata ishin t'u ikë veç, t'u ikë. N'drekë ka ardhë ushtria osht' fut n'qytet. Ka qenë ni emocion i paparë. Nanat që i lypshin fëmitë që ju kishin vra, plot djem të ri. Kish motra që e lypke vllaun. I shihsha me lot nëpër sy edhe thojsha qysh e vlerësojnë këto lirinë domethonë a e vlerësojnë këto lirinë. Ishin emocione t'përzine po apet thojsha pa gjak nuk mundet me ardhë asni e mirë. Se t'u e ditë çfarë egërsire kishim përballë.

Erdh... u bo ceremonia, u largum. Mislimi shkoj në shtab, i dorëzoj rrobat, e dorëzoj automatikun edhe po m'thotë tha, "Po m'vyjnë pantolla, kpuca", i thashë, "Kur t'thashë u djegë shpija m'the mshile gojën po t'nin kush", (qeshë). Po shkova te familja ime edhe aty u vendosëm me qëndru se s'kishim ku me nejt. Në ndëkohë qytetarët që ju kishin djegë shpitë kishin zanë shtëpija serbe. S'pranojke Mislimi kurqysh. Po edhe ktu i vijke, nuk ish i lirë te familja jeme. Sepse njeri i luftës, njeri i burgut. Nuk e nijke lirinë që i kish mungu tanë jetën. Me gjithë respektin që ia bojshin.

Kunati jem tha, "Mos e dëgjo Muslimin, duhesh me zanë ni banesë deri t'bojmë hall". Ai e ka zanë banesën edhe u vendosëm aty. Kom pa qat' testamentin e pata gjetë, anxhara. Kom pa bomba aty te ajo banesa. E pastrum, i dorëzum ato edhe filloj ni rrugëtim i ri për mu. Fillova msimin po duke qenë se Gjakova ish shkatërru shumë, e formum shoqatën e parë t'grusë në Gjakovë, '99-shi. Aty na vishin ndihmat me kamiona edhe na u shpërndajshim qityne nanave vet ushqyese, nanat që i kishin fëmitë n'burg, që ju kishin vra n'luftë. Kish mjaft, qyteti ish plot.

N'fakt përveç Drenicës Gjakova ka qenë ma e dëmtunja gjatë luftës. Qatyne grave që i kisha n'kujdesje ju marum shpijat, ato që vishin nga fshatrat. Pastaj, ktyne ju ndihmojshim edhe me t'mira materiale. M'u munu diçka me bo. Kaloj kjo kriza e parë edhe fillun, vishin delegacione t'huja çka lypshim na fabrika. "Jo", thojshin, "ju fabrikat i keni pasë politike se tash duhet m'u privatizu çdo gja". A din, tjetër organizim me pasë.

Niherë në kuadër të forumit por kur e bom shoqatën e parë forumi i dalë, gjysa shkoj me vazhdu politikën, gjysa him në shoqata humanitare. T'u punu qishtu si shoqatë e grusë na erdhën rastet e para. Na erdh ni vajzë nga Klina, baba i vet kish ushtru dhunë për shkak se ajo s'ka pranu m'u martu. Ka jetu në Zvicërr e ai e ka kthy në Kosovë, gjatë luftës domethonë ka jetu në Zvicërr, e ka kthy në

Kosovë për ta martuar. Ajo s'ka pranë e kish ushtru dhunë edhe ajo u ikë, u shku në polici edhe policia e prun. "Ju jeni shoqatë e grusë merrni vesh me to".

Qashtu na ndodhi me ni nanë me dy fëmi edhe kështu ia nisën m'u shtu rastet. Unë e mora qat' çikën n'shpi mandej ni shoqe jemja e mur' atë nanën me dy fëmi. Masnej rastet fillun m'u shtu edhe po i tregojmë Vjosës, Vjosës Dobruna. Po i thojmë kështu kështu osht' situata. Tha, "Unë ju boj projektin veç a jeni n'gjendje me punu". Unë e kisha shkollën nuk dojsa me punu tjetër gja. Aty e gjetëm projektin, na boni projektin edhe tha, "Dilni e gjeni shpinë tashti". Ku me gjetë shpinë, gjithkah ish shkum.

Qikjo shpi u gjet domethonë tash na e kemi shtu katin e kemi rritë por u gjet qikjo me ni çmim pak ma t'volitshëm edhe e blem. Kjo osht' pronë e shoqatës edhe fillun me rastet e para. Vit pas viti fillun pastaj m'u hapë edhe shoqata tjera, domethonë, strehimore tjera në Kosovë. Unë kom lobu. M'kanë thirrë në Gjilan, në Pejë, në Prizren. Kom lobu për m'u hapë edhe strehimore tjera. E kur u hapën strehimore tjera ktu filloj pak m'u letu puna. Ama fillimi ka qenë shumë, shumë i vështirë.

Ti nuk mumshe me marrë me mend që ni i afërm, ni babë çka munet m'i bo vajzës ose çka munet me i bo grusë t'vet. E pa kapshme për ne. Unë kisha dëgju që një i ri që konsumon alkool a din konsumon dhunë, po pse osht' dhuna kaq e përhapun unë nuk e kisha besu. Po apet thojsha, e ka hupë shpinë, e ka hupë punën edhe ai ka ku shfryhet ma shumë, te qata që i ka ma afër. A din, dhuna nuk ka arsytim po fillimi ka qenë i tillë.

Sot janë bo 24 vite që u hapë shpija. E quj sukses. Shumë nana kanë ecë përpara. Disa që s'kanë ditë çka kanë dashtë kanë mbetë po aty, disa kanë gjetë rrugën duke kriju lidhje t'reja, e disa duke u punësuar edhe duke marrë jetën e vet n'dorë t'vet, të fëmive edhe t'vetën.

Anita Susuri: Zonja Sakibe, po du m'u kthy pak te ni detaj, po mendoj, ni pjesë e rëndësishme e jetës t'uj që ka qenë studimi. Ju si vajzë atëherë u dashtë prej Gjakovës me ardhë në Prishtinë. Si ka qenë për juve krejt kjo eksperiencia? Ndrimi i vendit?

Sakibe Doli: Familje ime kishte dëshirë që unë t'bëhem mësuese. Unë s'dojsha. S'kisha dëshirë. Për këtë arsye e zgjosh gjimnazin për të studiuar. Kiminë e kom dashtë shumë por n'momentet e fundit vendosa gjuhë shqipe, m'flejke gjuha shqipe. Isha orientu shumë herët. Shkrujsha kah pak edhe thojsha e plotësoj. Lexojsha shumë libra, shumë. Unë ka netë që e kom fillu librin ditën edhe e kom përfundu n'mëngjes. Për m'i nejt besnik kësaj u regjistрова në gjuhë dhe letërsi shqipe.

Në... para meje vajzat e axhave që ishin ma t'mdhaja nuk e kishin vazhdu shkollimin e lartë, kishin mbetë te shkolla e mesme. Ndërsa baba im dallonte nga mixhollarët sepse ish ma i vogli edhe reflektonte ndryshe. Ai nuk kish hezitu edhe më kishte mundësu që unë të shkoj të studioj në

Prishtinë. Në Prishtinë kisha zanë shoqe t'reja sepse në gjuhë shqipe kish, prej qytetit tim kish pak njerëz. Domethonë kish ma shumë prej fshatrave dhe qyteteve tjera.

Aty pastaj ne krijonim lidhje tjera. Unë kom shoqe pothuajse në çdo komunë të Kosovës. Xheve Lladrovcin për shembull unë e kom pasë shoqe. Ajo ka qenë ma e re po unë e kom pasë shoqe t'fakultetit edhe shoqe t'mirë bile. Se Xheva shkrujke poezi të fuqishme edhe mu poezia m'kish lidh me Xhevën. Po tu e ditë që baba i saj ish atdhetar, i kishte gjetë eshtrat e Azem Galicës...

Anita Susuri: Azem...

Sakibe Doli: Azem Bejtës. E kisha ni informacion domethonë edhe ishim shoqëru shumë me ata. Ajo ishte nga Drenoci e na në Gjakovë i thojshin Laçka Drenoci. I thojsha, "Xhevë kur t'vish në Gjakovë mos e përmend qita se si serb po m'doket" (qeshë). Domethonë pas fakultetit nuk kemi pasë ma sepse ajo i ka vazhdu studimet, unë veç jom kthy jom punësu.

Në Prishtinë domethonë kjo mundësia e parë që e ke hapë rrethin shoqëror edhe aty organizoheshin demonstrata, protesta. Njëpër konvikte për shembull ka pasë... unë s'kom nejt në konvikt kom nejt në ni banesë private. Vllau im ish student po ashtu. I kisha, me shoqe t'qytetit dilshim kah niherë në javë. Korza ka qenë atëherë shumë në formë. Po shkojshim edhe niherë në javë në Pejë. Në teatër nuk kemi shku fort. Sepse teatri edhe ka qenë ma i vogël edhe ka pasë kërkesa shumë aty. S'kishe mundësi me ardhë deri te teatri.

Jeta në Prishtinë osht' ni ndryshim domethonë prej qytetit ton osht' nifar' fryme tjetër, nifar' pavarësie si femër, si vajzë. Tashti ajo liria kur nuk keqpërdoret t'rrit edhe t'bon ma krenare edhe ma t'fuqishme. Ni vështirësi që e kom pasë ka qenë letërsia jugosllave. Na ka japë Hasan Mekuli që shumë studenta e kanë lanë fakultetin për shkak t'qatij provimi. A besoni që unë i kam lexu 138 vepra të letërsisë jugosllave pa asni interes. Ka pasë slloven, kroat në ni po këta tjerët nuk ia kanë vlejte me i lexu.

Profesori ka qenë shumë kërkues. Në detaje t'i lypke. Ivo Andriqi⁷ i cili ka bërë politika për Kosovën m'i lexu veprat e tij ka qenë tmerr. Por, në qoftëse dojshe me kry fakultetin u dufshe m'i lexu patjetër. Na të gjithë e kemi pasë inat atë profesor. Por kur diplomum, diqysh e ndrrum mendimin sepse ai kish qenë shumë i mirë edhe ai kish pasë për qëllim që na ta njohim ma mirë kush osht', kush janë shkrimtarët, kush janë serbët në të vërtetë. Çfarë mendojnë ata për ne. Ura mbi Drin domethonë aty krejt t'kqijat për shqiptartë i kemi lexu.

Kështu që e kom kry domethonë në afat. Përveç letërsisë jugosllave pak që më ka zgjatë. E kom dashtë shumë sintaksën edhe gramatikën, i kom dashtë shumë. Nuk kom pasë problem. Temën e kom pasë marrë Lumin e Vdekur të Jakov Xoxa, periudha ka qenë, periudha kohore, te romani Lumi i Vdekur i

⁷ Ivo Andriq (9 tetor 1892 – 13 mars 1975) shkrimtar serbo-kroat dhe diplomat nga Bosnja dhe Hercegovina, fitues i Çmimit Nobel për letërsi për vitin 1961.

Jakov Xoxës. Domethonë kom pasë me analizu krejt librin, me gjetë periudhën me nënrenditje kohore. Domethonë...

E kom punu edhe temën, jom mundu vet sepse atëherë nuk ka pasë mundësi me të ndihmu dikush. Normalisht me profesorin në konsultime. E kom dashtë Prishtinën sepse t'bon për veti si qytet. Po kur e kom kry pastaj ma nuk m'u ka dokë shumë interesante. Nashta qyteti yt t'ngreh ma shumë. Tash ka ndryshu shumë m'pëlqen po ka problemet e veta. Komunikacioni i rënduar që t'mërzit shpejt.

Anita Susuri: Në cilat vite ju e keni regjistru?

Sakibe Doli: '75.

Anita Susuri: '75-ten.

Sakibe Doli: Po.

Anita Susuri: Ka qenë pikërisht viti kur osht' '74-ten domethonë kur osht' formu universiteti...

Sakibe Doli: Po, po, po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë për shembull krejt ajo, si me thanë, ajo suazat e para nëse mundeni me na tregu? Për shembull edhe profesorët, a ka pasë prej Shqipnisë n'atë kohë?

Sakibe Doli: Kemi pasë profesora shumë t'mirë, n'moshë. Besim Bokshi ka qenë i Gjakovës që na ka japë morfologjinë historike. Ka qenë psikolog. Na ka pa disponimin n'sy, n'fytër na ka lexu. "Sot nuk qenkët për provim", t'ka liru. Shpjegimi ka qenë fenomenal. Idriz Ajeti, profesor t'nivelit t'lartë, akademik. Këta tanë akademika kanë qenë që na kanë dhanë msim.

Se shpesh herë thojshin, me humor thojshin, në gjuhë shqipe regjistrohen 30 e kryjnë 31 (qeshë). Por, kur ju thojsha unë shikoni kush na ka japë msim. Domethonë Isa Bajçinca. Pastaj vllau i Fehmi Aganit, Suki Agani. Domethonë profesora të gjithë njerëz të moshuar dhe akademik të Institutit Albanologjik të Akademisë të Shkencave që na kanë dhanë msim edhe unë jom shumë krenare për ta.

Fillimi i universitetit osht' pak derisa t'njihesh me kolege, derisa t'i kuptojsh arsimtarët, profesorat, osht' pak i vështirë. Por, megjithatë domethonë varet edhe prej personalitetit, prej personit se sa je i aftë m'u kyç. Se tashti unë plot shoqe të Gjakovës që për shembull janë shku me ni fakultet ku kanë qenë katër-pesë veta bashkë, unë isha vetëm. Kjo është pak e vështirë për ni fillestare si studente. Ani pse e kisha kry gjimnazin dhe kisha përvoja t'ndryshme t'jetës.

Po megjithatë kadal kadale e bojsh rrethin edhe kur e krijon rrethin ton atëherë e ki... ne dilshim n'mramje me shoqe të Gjakovës por në fakultet pastaj edhe aty fillojshin m'i gjetë ato të idealit, shoqe të idealit. Me kriju atë besimin që me ia nisë m'u hapë edhe me folë. Për shembull me Xhevën na kemi bisedu e biseda serioze, biseda që kishin t'bojnë me çështje tjera jo vetëm për msimin. Kjo t'bon ma t'pasur, njeh kulturat e viseve tjera të Kosovës edhe t'forcon ma shumë edhe t'bon ma t'dashur, njeri ma t'dashur.

Anita Susuri: Zonja Sakibe, nëse doni për fund edhe diçka me shtu...

Sakibe Doli: Faleminderit prej jush, domethonë, që m'keni gjetë (qeshë).

Anita Susuri: Faleminderit!

Sakibe Doli: Shumë gjëra i kam harru sepse kur s'përsëriten gjërat harrohen. Nuk e di sa kom kontribu domethonë në prezentimin tim. Kur m'kanë thanë ma s'pari me prezentu vetën, m'ka ardhë turp. Thojsha qysh fol njeri për vetën. Por jeta kështu e paska. Meniherë pas luftës e kom pasë dhanë ni intervistë te Instituti Albanologjik, qysh i thojnë, oral history...

Anita Susuri: Po, histori gojore.

Sakibe Doli: Po, histori gojore e thojsha jo nuk muj, nuk muj. Menzi që m'ka pasë bindë ajo studjusja po po msojka njeri. Se kom dhanë edhe intervista. Unë kesh shumë e thjeshtë, shumë popullore.

Anita Susuri: Faleminderit shumë, ishte knaqësi!